



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C. nr. 687/2006

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësve M. K., A. K.1, A. K.2 dhe A. K.3, që të gjithë nga P., rr..., nr..., tre të parët i përfaqëson i autorizuari av. A. K., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal B. M., me objekt të padisë kompensim, vlera e kontestit 1000 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.28.05.2014, morri këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësve M. K., A. K.1, A. K.2 dhe A. K.3, që të gjithë nga P.,

DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të pjesës së marrur të pronës së paluajtshme pa bazë ligjore, në sipërfaqe prej 32m², në ngastrën kadastrale nr.4051, tu kompensojë shumën e përgjithshme prej 16.000 euro, dhe atë me kamat ligjore si për mjete të deponuara pa destinacion të caktuar nëpër Banka private të Republikës së Kosovës, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të kësaj procedure paditësit të ia paguaj shumën prej 1365 euro, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë më tepër se shuma e aprovuar prej 16.000 euro e deri në shumën prej 25.600 euro, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ngel në tersi si në padi dhe në seancat paraprake. Në Fjalën Përmbyllëse ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave u vërtetua se i padituri me rastin e ndërtimit të murit mbajtës dhe shtrimit të rrugës në kubëza në rrugën..., në Prizren, pa bazë ligjore ka marrë një pjesë nga pronësia e ngastrës kadastrale nr.4051, në sipërfaqe prej 32 m², pronë e paditësve. Duke patur parasysh këtë fakt se sipërfaqja e lartë cekur e paditësve është bërë pjesë e rrugës dhe atë pa zhvilluar paraprakisht një procedurë të eksproprijimit ekziston përgjegjësia dhe obligimi i të paditurit për kompensimin e pjesës së marrur të paluajtshmërisë së paditësve. Sa i përket ekspertizës vlerësuese konsideroj se nuk është marrë parasysh fakti këtu kemi të bëjmë me marrjen e një pjesë të oborrit të paditësve mu para shtëpive të tyre familjare i cili fakt do të ndikonte në vlerësimin më të madhe të vlerës së kësaj pjese të paluajtshmërisë. Andaj propozojmë gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e precizuar të paditësve të paraqitur

në seancën përgatitore. Shpenzimet e procedurës i kërkoi për përpilimin e padisë shumë prej 100 euro, në emër të ekspertizës gjyqësore shumë prej 100 euro, për ekspertizën vlerësuese të paluajtshmërisë shumë prej 100 euro, për 5 seanca gjyqësore shumë prej 675 euro, për dy seanca të shtyra gjyqësore shumë prej 130 euro si dhe shpenzimet për taksa gjyqësor (ankesa 100 euro, padi 80 euro, Aktgjykim 80 euro) gjithsej 260 euro, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1356 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës B. M. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kundërshton raportin e vlerësimit të patundshmërisë të dt.03.04.2014, të paraqitur nga eksperti N. G., në rrethanat se shuma e vlerësimit e paraqitur në këtë ekspertizë është e lartë pasi që nuk përkon me vlerësimin real të sipërfaqes për metër katror në atë pjesë, eksperti përveç raportit të përpiluar nuk ka paraqitur ndonjë provë se sa llogaritet vlera për metër katror në atë pjesë të qytetit. Në fjalën përfundimtare i njëjti ka deklaruar se me administrimin e provave të deri tanishme nuk është kontestuese se organet e shërbimeve publike të KK Prizrenit kanë ndërmarrë veprime lidhur me zgjerimin e rrugëve dhe parqeve të qytetit, kjo për interesa publike dhe duke pasur parasysh dëmin e vogël dhe vlerën e vogël si dhe pajtimin e heshtur të shumicës së qytetarëve për veprimet e tilla Komuna e Prizrenit, nuk ka mundur të zhvillojë procedura të shpronësimit për arsyet të cilat u cekën, andaj kundërshtimet e mia lidhur me kërkesëpadinë e paditësit kanë të bëjnë më së shumti me vlerën e lartë të shumë në të holla e cila kërkohet si dhe për shpenzimet e kërkuara procedurale andaj në këtë drejtim duke qëndruar si në thëniet e deri tanishme si dhe përgjigjen në padi nga gjykata kërkohet që padia e paditësve në parim të refuzohet si e pabazë, ndërsa nëse sipas vlerësimit të gjykatës ka elemente të cilat e arsyetojnë kërkesën e paditësve rrugët ligjore për të gjitha palët mbeten të hapura për atakimin e vendimit apo ndonjë prove eventuale. Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë shikimin e aktvendimit T.nr.282/04, shikimin e kopjes së planit nr.019 të dt.07.03.2005, shikimi në kërkesën e dt.03.02.2003, shikimi në kërkesën drejtuar Bordit të Drejtorëve dt.22.04.2004, shikimi në përgjigjen e Drejtorisë për çështje Pronësore Juridike nr.03/3 të dt.28.12.2004, leximi i procesverbalit i daljes në vend me dt.28.02.2005, shikimi në raportin e vlerësimit të patundshmërisë të përpiluar nga eksperti N. Gj. të dt.03.04.2014, si dhe marrja në pyetje e ekspertit N. Gj..

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Me shikimin e aktvendimit T.nr.282/04, të dt.04.11.2004, gjykata ka konstatuar se trashëgimia e trashëgimlënësit S. K. ish nga Prizreni përbëhet nga pasuria e paluajtshme e evidentuar si parcela kadastrale nr.13, 636/1, 2224, nga flet posedimi nr.555 KK Korishë, parcela kadastrale nr.4051 nga fletposedimi nr.2633 KK Prizren, ndërsa si trashëgimtarë të kësaj pasurie shpallën M., A.1, A.2 dhe A. K.3 këtu paditësit, me nga ¼ pjesë ideale në tërë pasurinë e paluajtshme..

Me shikimin e kopjes së planit nr.019 të dt.22.11.2004, gjykata ka konstatuar se në paluajtshmerin e evidentuar si parcela kadastrale nr.4051 me kulturë shtëpi 87m2, oborr

500m² dhe arë 144m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 731m², muri është i ndërtuar në dëm të kësaj parcele kadastrale në sipërfaqe prej 0.00,32 ha (32m²), dhe është shënuar me ngjyrë të kuqe, ndërsa me ngjyrë të zezë është shënuar kufiri i ngastrës.

Me shikimin në kërkesën e dt.03.02.2003, gjykata ka konstatuar se i ndjeri S. K., paraardhësi i paditësve i është drejtuar me kërkesë të paditurës me arsyetimin se është pronar i shtëpisë në rrugën ..., nr..., ku ka arsyetuar se muri i cili ndanë rrugën me oborin e shtëpisë është dëmtuar shumë dhe paraqet rrezik për njerëzit pasi që përveç funksionit si mur ka edhe funksion të mbajtjes së rrugës nga rrëshqitja, i ka ftuar që të dalin në vend të ngjarjes dhe të konstatohet gjendja faktike dhe të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme që do të evitonin rrënimin e rrugës, për të mirën e përgjithshme.

Me shikimin në përgjigjen e Drejtorisë për çështje Pronësore Juridike nr.03/3 të dt.28.12.2004, gjykata ka konstatuar se kjo Drejtori i është përgjigjur kërkesës së ushtruar nga ana e paditësve nr.01-463-216 të dt.06.12.2004, për marrjen e vendimit për shkak të heshtjes së administratës, ku e paditura e ka arsyetuar këtë përgjigje se në bazë të shkresave pranë Drejtorisë për çështje pronësoro-juridike, gjeodezi dhe kadastrë, ky shërbim ka konstatuar se nuk është zhvilluar procedura e marrjes nga shfrytëzimi-pronësia e pjesës kontestuese. Në bazë të Ligjeve të aplikueshme inicimi i procedurës për marrjen nga shfrytëzimi-posedimi është dashtë të bëhet para se të ndërtohet objekti. Mirëpo një gjë e e tillë nuk ka ndodhur, procedura në afat ligjor nuk është zhvilluar andaj e ka udhëzuar që të drejtat e tyre ti realizojnë përmes rrugës gjyqësore.

Me leximin e procesverbalit të daljes në vend me dt.28.02.2005, gjykata ka konstatuar se nga dalja në vend të ngjarjes në rrugën ..., nr..., ka konstatuar se vërehet një mur i ndërtuar me beton në gjatësi prej 30 m, lartësia përafërsisht 5 m. Një pjesë e murit është ndërtuar me beton ndërsa përmbi beton është ndërtuar me blloka të betonit 4 rende në parcelën 4051. Ekspertja e gjeodezisë në vendin e ngjarjes ka deklaruar se në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr.4051 pronë e paditësve është ndërtuar muri me material të fortë në gjatësi prej 26 m i cili është në gjatësi tërë parcelës dhe e njëjta kufizohet me rrugën e në lartësi prej 4-6.

Me shikimi në raportin e vlerësimit të patundshmërisë të përpiluar nga eksperti N. Gj. të dt.03.04.2014, si dhe marrja në pyetje e ekspertit N. Gj., gjykata është njoftuar me formën dhe mënyrën e vlerësimit të pjesës së parcelës kontestuese, ku nga kjo ekspertizë eksperti ka ardhur në përfundim dhe ka dhënë vlerësimin e tij se kjo pjesë e parcelës kadastrale kontestuese nr.4051 në sipërfaqe prej 32 m², e ka vlerësuar me çmimin e përgjithshëm prej 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) euro. Ky vlerësim sipas ekspertit është bërë duke e shikuar data bazën e tyre dhe nga bisedat e kryera si dhe nga ofertat dhe kërkesat në tregun e paluajtshmërive gjatë muajve të fundit në lokacionin e ngushtë të ngastrës kontestuese.

Në rastin konkret, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas bindjes së kësaj gjykate pretendimet e palës paditëse, janë të bazuara pasi që në tersi u vërtetua se e paditura pa ndonjë bazë ligjore me rastin e ndërtimit të murit në rrugën ..., në gjatësi prej 30 m, lartësia përafërsisht 5 m i ka shkaktuar dëm palës paditëse, me marrjen e një pjesë nga pronësia e ngastrës kadastrale nr.4051, në sipërfaqe prej 32 m², pronë e paditësve, duke mos bërë paraprakisht eksproprijimin dhe as kompensimin e kësaj pjese të ngastrës kontestuese. Kjo pjesë e ngastrës kadastrale kontestuese është bërë pjesë e rrugës pa asnjë bazë ligjore

duke mos respektuar Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së kësaj pjese të ngastrës kontestuese. Në rastin konkret e paditura nuk e ka bërë shpronësimin dhe as që e ka kompenzuar pjesën e marrur pa bazë Ligjore. Nga këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 172 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (G.Z. e RSFJ 30/78), Personi Juridik përgjigjet për dëmin që i shkakton organi i tij personit të tretë gjatë ushtrimit të veprimtarisë të funksioneve të veta.

Personi juridik në rastin konkretë është Komuna e Prizreni. Mirëmbajtja dhe rregullimi i rrugëve brenda qytetit të Prizrenit është veprimtari që hynë në kuadër të funksioneve të Komunës e cila në këtë çështje kontestimore është palë e paditure. Andaj është edhe përgjegjëse për dëmin e shkaktuar personave të tretë gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e sajë. Mirëpo diuke pasur parasysh faktion se pafajësinë nuk ka mundur ta provon me asnjë provë të vetme, pasi që barra e provave për të argumentuar pafajësinë e sajë i ka takuar Komunës së Prizrenit si Person Juridik, gjykata ka vendosur që të aprovon pjesërisht kërkesëpadinë si të bazuar.

Lidhur me shumën për kompensimin e paluajtshmërisë të cilën kjo gjykatë e ka aprovuar është bazuar në vlerësimin të cilin e ka dhënë eksperti i vlerësimeve. Gjukata ka pasur për bazë edhe faktin nëse ndërtimi i rrugës e ka rritur vlerën e paluajtshmërisë, mirëpo eksperti ka sqaruar se rruga ka qenë e shtruar me kalldrëm dhe ndërtimi i asaj rruge nuk ka ndikuar aspak në shtimin e vlerës së saj, gjë që gjykata këtij konstatimi i ka kushtuar besimin.

Pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumën e aprovuar gjykata e ka refuzuar pasi që e njëjta nuk është dëshmuar me ndonjë provë konkrete.

Gjukata administroi edhe kërkesën drejtuar Bordit të Drejtorëve dt.22.04.2004, mirëpo konsideroi se kjo provë nuk paraqet ndonjë ndikim lidhur me marrjen e vendimit

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.687/06, datë 28.05.2014

Gjyqtari
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjukatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.